



21 PRILL 2015

INCIDENTET DHE TENSIONET NË MITROVICË: NEVOJA PËR RAPORTIM OBJEKTIV DHE FORCIM TË SUNDIMIT TË LIGJIT

Duke marrë parasysh zhvillimet e kohëve të fundit dhe përshkallëzimin e dhunës në Mitrovicë, ECMI Kosova afirmon qëndrimin e saj se është me rëndësi thelbësore që të gjitha incidentet e ndodhura të ekzaminohen në mënyrë individuale, në mënyrë të shpejt dhe transparente, nga autoritetet përkatëse, për të parandaluar incidente të mëtejme dhe për të rritur besimin e të gjithë qytetarëve në sundimin e rendit dhe ligjit. Si shumë herë më parë, incidentet janë interpretuar si të motivuara etnikisht në mënyrë të shpejtuar, ndonëse nuk ka bazë të shëndoshë për të arritur përfundime të tilla. Prandaj, ECMI Kosova u bën thirrje të gjitha medie dhe politikanëve që të marrin përgjegjësinë e tyre dhe të përmbahen nga dhënia e përfundimeve të pabazuara rreth motiveve etnike prapa këtyre incidenteve, në mënyrë që të shmangët rritja e tensioneve etnike.

Më 9 prill, një i ri i komunitetit serb 17-vjeçar është sulmuar dhe është goditur me thikë në gjoks nga një grup i personave të panjohur në Mitrovicë të Veriut, shumë afër urës kryesore mbi lumin Ibër. Dëshmitarët okularë kanë raportuar se grupi i dyshuar nëpërmjet urës në lumin Ibër iku në anën jugore të qytetit. Policia e Kosovës është ende në kërkim të identifikimit të kryerësve të veprës.¹ Tre oficerë të policisë që në momentin e kryerjes së veprës kishin qenë në patrullën statike të vendosur në urën kryesore mbi lumin Ibër janë pezulluar, duke marrë parasysh faktin se ka pasur raportime të shumta nga dëshmitarë okularë që kanë deklaruar se këta zyrtarë policorë nuk kanë ndërhyrë fare në këtë situatë. Përfaqësues përkatës të qeverive të Kosovës dhe Serbisë, si dhe atyre të Zyrës së BE-së në Kosovë e kanë dënuar sulmin mbi të riun serb.²

Duke nxjerr përfundime vetëm nga dëshmitë e dëshmitarëve okularë që kishin deklaruar se kanë parë kryesit e veprës duke ikur në pjesën jugore të qytetit të Mitrovicës, mediet serbe menjëherë apo shumë shpejt pas incidentit kanë deklaruar se incidenti ishte etnikisht i motivuar. Marko Gjuriq, shef i Zyrës për Kosovën pranë Qeverisë së Serbisë, e mori përsipër këtë interpretim dhe deklaroi se sulmi mbi të riun serb ishte i pretenduar mbi baza etnike shumë afër urës mbi lumin Ibër vendit që do duhej të ishte një simbol i paqes, unitetit dhe pajtimit. Në mënyrë të ngjashme, Aleksandar Jablanović nga lista Srpska, e ka klasifikuar sulmin si "të motivuar mbi baza etnike".³

¹ http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=04&dd=09&nav_category=640&nav_id=979102;
http://kossev.info/strana/arhiva/nikola_saveljic_stabilno_uskoro_izlazi_iz_bolnice/4536;
<http://www.zeri.info/kronika/27826/tensionohet-serish-situata-ne-mitrovice/>

² <http://www.kosovaonline.info/?page=1,3,61521>; <http://www.zeri.info/kronika/27826/tensionohet-serish-situata-ne-mitrovice/>; <http://www.blic.rs/Vesti/Hronika/549710/Izboden-mladic-srpske-nacionalnosti-u-Kosovskoj-Mitrovici>

³ http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=04&dd=09&nav_category=640&nav_id=979102

Pas incidentit, situata në Mitrovicën Veriore ishte shumë e tensionuar. Një ditë pas incidentit të therjes së të riut serb, në një seri prej tre zënkave të veçanta në pjesën veriore të Mitrovicës janë plagosur lehtë pesë qytetarë shqiptarë dhe dy boshnjakë.⁴

Po të njëjtën ditë, një i ri 17-vjeçar shqiptar u zhduk në afërsi të lumit Ibër; thuhet që i riu të jetë zhdukur pas një përpjekje të grabitjes. Përkundër operacionit të gjerë të kërkim-shpëtimit nga ana e njësiteve të specializuara të Policisë së Kosovës, EULEX-it, Forcave të Sigurisë së Kosovës, dhe KFOR-it, nuk janë gjetur gjurmë të djalit të zhdukur deri tani. Policia e Kosovës ka arrestuar, dhe më pas liruar, dy serbë nga Mitrovica Veriore që ishin dëshmitarë të rastit.⁵

Në orët e hershme të natës së 12-13 prillit, dy persona janë plagosur në një zënkë mes bandave të të rinjve nga Mitrovica Veriore dhe Zveçani para një klubi të natës në Mitrovicën Veriore.⁶ Pothuajse në të njëjtën kohë, është qëlluar një makinë e policisë së Kosovës në Mitrovicën e Veriut.⁷ Në mbrëmjen e 13 prillit, u raportua se në stacionin Policor të Kosovës në komunën e Zubin Potokut është hedhur një mjet shpërthyes, dhe se në ndërtesën e Policisë së Kosovës janë vendosur mbishkrime kundër Policisë së Kosovës dhe EULEX-it.⁸

Këto incidente para së gjithash tregojnë dobësinë e sundimit të rendit dhe ligjit në veri të Kosovës dhe pasigurinë e vazhdueshme me të cilën përballen qytetarët e zakonshëm. Në këtë aspekt, ECMI Kosova bën thirrje që të gjitha rastet e ndodhura ditëve të fundit të hetohen në mënyrë transparente dhe të shpejtë nga autoritetet përkatëse dhe që forcat e sigurisë të rrisin praninë e tyre në vendet potencialisht kritike. Prandaj, ECMI Kosova e mirëpret takimin mes ministrit Lubomir Mariq, kryetarit të komunës së Mitrovicës Veriore Rakiq, dhe kryetarit të komunës paralele serbe të Mitrovicës Aleksandar Spiriq me përfaqësues të Policisë së Kosovës, EULEX-it, dhe KFOR-it, ku janë kërkuar masa urgjente dhe rritje e pranisë së pjesëtarëve të Policisë së Kosovës në vende potencialisht kritike.⁹ Vigjilenca e rritur e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës menjëherë është provuar efektive, kur të dielën më datë 19 prill, policia arrestoi gjashtë të rinj shqiptarë dhe serbë, pjesëtarë të bandave të të dy komuniteteve, të cilët përmes medieve sociale ishin duke përgatitur një zënkë mes bandave në afërsi të urës kryesore mbi lumin Ibër.¹⁰

Përveç kësaj, incidentet e kohëve të fundit tregojnë se sa lehtë rastet e dhunës mund të gjenerojnë tensione etnike në veri të Kosovës, ndonëse motivet etnike rrallë herë qëndrojnë si motiv kryesor prapa dhunës. Për të parandaluar përshkallëzimin e tensioneve të tilla, mediet dhe politikanët kanë përgjegjësinë e përbashkët për të raportuar në mënyrë objektive dhe për të mos përdorur dhunën dhe incidentet për agjendat e tyre politike. Si rezultat i përkufizimit të nxituar si incident etnikisht i motivuar i sulmit të 9 prillit, shumë nga incidentet pasuese kanë qenë të lidhura mbi bazën e ndarjes etnike, shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar, edhe pse insinuata të tilla janë të pabaza apo edhe tërësisht kontradiktore me faktet. Disa media dhe politikanë nuk kanë reaguar në mënyrë të përgjegjshme duke mos marrë parasysh shpërthimin e mundshëm të tensioneve etnike në raste dhe situata të tilla.

Shpresojmë që takimi midis kryetarit të Mitrovicës Veriore, Rakiq, dhe kryetarit të komunës së Mitrovicës Jugore, Agim Bahtiri, të shërbejë si shembull në këtë drejtim. Në mbrëmjen e 11 prillit, menjëherë pas publikimit të lajmit për zhdukjen e të riut shqiptar, dy kryetarët u takuan dhe lëshuan një deklaratë të përbashkët në të cilën ata paralajmëruan për një përshkallëzim të

⁴ http://kossev.info/strana/arhiva/napad_na_maloletnog_albanca_u_centru_severne_mitrovice/4523

⁵ <http://www.telegrafi.com/lajme/ndalohen-dy-serbe-ne-lidhje-me-zhdukjen-e-sead-alushit-2-61747.html>;
http://kossev.info/strana/arhiva/ukinut_pritvor_dvojici_srba/4553.

⁶ http://kossev.info/strana/arhiva/u_pucnjavi_u_kosovskoj_mitrovici_dvoje_povredjeo_/4541.

⁷ http://kossev.info/strana/arhiva/tri_hica_na_vozilo_kosovske_policije/4542.

⁸ <http://live.kallxo.com/sq/MTL/Porosite-e-Sulmit-me-Granate-ne-Stacionin-Policor-te-Zubin-Potokut-6024>.

⁹ http://kossev.info/strana/arhiva/maric_rakic_i_spiric_na_sastanku_sa_rukovodstvom_kp_a_na_severu/4592.

¹⁰ <http://koha.net/?id=3&l=53792>.

mundshëm në bazë të përkatësisë etnike, duke u bërë thirrje qytetarëve që të mos bien për provokimet e mundshme dhe ngarkesat emocionale nga të dy palët dhe të rrezikojnë paqen e brishtë që është arritur pas shumë viteve të animozitetit mes palëve. Për më tepër, të dy kryetarët bënë thirrje për prani më të shtuar të forcave të sigurisë dhe masave urgjente, në mënyrë që të rivendoset rendi publik dhe të zbuten tensionet. Ata gjithashtu u bënë thirrje “përfaqësuesve politikë të Beogradit dhe Prishtinës që me autoritetin dhe punën e tyre transparente të mbrojnë të gjithë qytetarët e Mitrovicës nga pasojat eventuale të padëshiruara.”¹¹

Për më shumë informacion ju lutem na kontaktoni në + 381 (0) 38 224 473, apo përmes e-mail-it: info@ecmikosovo.org

11

http://kossev.info/strana/arhiva/hitan_sastanak_dvojice_gradonacelnika_na_mestu_pretrage_za_nestalim_albans_kim_mladicem_smiriti_tenzije_i_zastititi_stanovnistvo/4533.

Raporte dhe analiza të tjera politike:

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Çfarë është e \(pa\)mundur në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës?](#)

16 prill, 2015

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: një klub ekskluziv i bazuar në përkatësinë ethnike?](#)

31 mars, 2015

[Komunitetet pakicë jo-serbe të neglizhuar në marrëveshjet teknike në mes të Kosovës dhe Serbisë](#)

10 mars, 2015

[Deklarata e diskutueshme e ministrit Murati dhe reagimet që pasuan](#)

5 mars, 2015

[Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe: Shumë spekulime, pak marrëveshje faktike dhe mos-zbatim](#)

22 shkurt, 2015

[Një sistem i unifikuar juridik dhe gjyqësor në Kosovë?](#)

15 shkurt, 2015

[Çfarë duhet të mbahet mend nga rasti Jablanović?](#)

8 shkurt, 2015

[Thirrje për Arsye dhe Veprim pas protestave në Prishtinë](#)

25 janar, 2015

[Farkimi i një ambienti të punës në kuadër të Qeverisë së Kosovës](#)

19 janar, 2015

[ECMI Kosova dënon bllokadën e dhunshme të hyrjes në Kishën Ortodokse Serbe në Gjakovë](#)

7 janar, 2015

[Formimi i Qeverisë së re të Kosovës, Përfaqësimi i komuniteteve pakicë dhe Sfidat që dalin përpara](#)

10 dhjetor, 2014

[Partitë politike të minoriteteve në mjedisin politik në ndryshim e sipër në Kosovë](#)

31 korrik, 2014

[ECMI Kosova bën thirrje për qetësi pas përshkallëzimit të tensioneve ethnike pas ndeshjes kualifikuese në futboll midis kombëtareve të Serbisë dhe Shqipërisë](#)

15 tetor, 2014

[Ndërlidhja e ndarjes: Krijimi i një Bordi të Përbashkët për qytetin e Mitrovicë](#)

27 qershor, 2014

[Zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë: Një Shikim i Çështjeve, sfidave dhe skenës politike në prag të zgjedhjeve të 8 qershorit](#)

2 qershor, 2014

Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-ethnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëpunuar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.